



KOMUNË E GJAKOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA

01 Nr. _____ /2019

Datë: 28.03.2019

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, dhe në nenin 12 të Statutit të Komunës së Gjakovës, në mbledhjen e mbajtur me dt, 28.03.2019 pas diskutimeve lidhur me piken e 10 te rendit te ditës : Diskutim dhe miratimi i deklaratës për adresimin e pabarazisë gjinore dhe veprimet që duhet të përmbushen në funksion të barazisë së plotë gjinore, e miratoi këtë:

DEKLARATË

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës përmes këtij akti deklaron vullnetin dhe përkushtimin për tu angazhuar në vazhdimësi përmes adresimit në Institucionet përkatëse të dhunës në familje dhe parandalimin e sajë, në bazë të kompetencave që ka. Në Funksion të rritjes së vetëdijes së institucioneve dhe shoqërisë në përgjithësi mbi dhunën në familje, Kuvendi i Komunës së Gjakovës nxjerrë këto rekomandime :

1. Gjatë planifikimit të buxhetit të komunës të zbatohet në mënyre më efektive mekanizmi për buxhetim të përgjithshëm gjinorë.
2. Të miratohet plani gjinorë i veprimit dhe zyra për barazi gjinore të raportoj në Kuvendin e Komunës një here në vite për punën dhe aktivitetet e kësaj zyre.
3. Të rritet përkrahja për gratë në biznes dhe subvencionimi i iniciativave lokale të grave.
4. Themelimi i komitetit për barazi gjinore dhe fuqizimi i mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje.
5. Masat parandaluese dhe dënuese ndaj gjuhës diskriminuese ndaj grave në institucionet lokale
6. Të vazhdoj raportimi në baza vjetore pranë Kuvendit Komunal nga KKSBB (Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi), QPS (Qendra për Punë Sociale) dhe Komandantit të stacionit të Policisë lidhur me rastet e dhunës në familje dhe jashtë saj.
7. Përkrahja financiare strehimores së viktimave të dhunës në familje dhe mbështetje për viktimat e dhunës.
8. Identifikimi dhe përkrahja për nënat vetushqyese.
9. Të organizohen aktivitetet të ngjashme si ajo "Java e Gruas" ose "Java kundër stigmës" në nivel lokal .

2. Obligohen organet e administratës Komunale, dhe institucionet tjera përgjegjëse që ti marrin të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtyre rekomandimeve të cekura më lartë .

3. Iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini.
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal
- Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
- Arkivit



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Anton Shala